




Duke u bazuar në dispozitat e nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040 dispozitat e Ligjit, nr.04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, si dhe duke marrë parasysh gjendjen emergjente të krijuar si pasojë e zjarreve të shumta në territorin e komunës së Klinës ditëve të fundit, me propozimin e DSHPE, lëshojmë këtë:

V E N D I M



KONFIRMOHET, se nga data 08.01.2026, komisioni komuna për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të mira materiale nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e komunës me vendim të kryetarit 01-Nr-112-681/2026 të datës 08.01.2029 më propozimin e drejtorit të DSHPE dhe aprovimin e kryetarit ka filluar daljen në terren me vlerësimin e dëmeve në terren për shkak të situatës së krijuar si pasojë vërshimeve të Komunës së Klinës. Gjendja e situatës emergjente për ngritje të nivelit të gatishmërisë vazhdon ende për shkak të situatës me vërshime deri në vlerësimin përfundimtar të dëmit. Lidhur me punët shtese jashtë orarit të punës të përmendurit do të kompensohen në përputhje me legjislacionin në fuq. Ky vendim ka karakter konfirmues dhe përdoret për kompensimet për përbërjen e komisionit.

- Te njoftohen: DSHPE;
- Zyra e personelit;
- Drejtoria e Financave,
- si dhe; Arkivi.

Kryetari

Zenun Elezaj

